



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës dhe të Udhëzimit Administrativ nr. 13/2013 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë publikon këtë:

N J O F T I M
PËR MBAJTJEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS, SI DHE MUNDËSINË
SHTESË PËR PAGESËN E PROVIMIT PËR AFATIN E SHTATORIT 2021

Njoftohen kandidatët, të cilët kanë aplikuar për dhënien e Provimit të Jurisprudencës në afatin e **Shtator 2021**, se provimi me shkrim do të mbahet me datat, si në vijim:

- **Lënda: E Drejta Penale do të mbahet me datë 23 tetor 2021 (e shtune) me fillim në ora 09:00, provimi do të zgjasë 5 (pesë) orë;**
- **Lënda: E Drejta Civile do të mbahet me datë 24 tetor 2021 (e diele) me fillim në ora 09:00, provimi do të zgjasë 5 (pesë) orë.**

Vendi i mbajtjes: Akademia e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri.

Po ashtu njoftohen kandidatët të cilëve iu është njohur e drejta për të hyrë në Provim të Jurisprudencës në afatin e shtatorit 2021, e të cilët ende nuk e kanë kryer pagesën, të njëjtit mund të bëjnë pagesën me datën 14 - 15 tetor 2021.

Fletëpagesa mund të merret nga data 14 -15 tetor 2021 në Ministrinë e Drejtësisë, kati përdhës në recepcionin e Ministrisë së Drejtësisë.

Do të konsiderohet se është bërë pagesa dhe kandidati do të mund t'i nënshtrohet Provimit të Jurisprudencës, vetëm atëherë kur e sjellë fletëpagesën e lëshuar nga banka.

Për informata të hollësishme mund të drejtoheni në web faqen e Ministrisë së Drejtësisë <http://www.md-ks.org> apo kontaktoni në, tel: 038 200 18 353.